




KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

K.R.M. "ÇABRATI"

Tel. +383(0)390/321 588
+383(0)390/324 034
+383(0)46 19 55 55
www.cabrati.com
e-mail: info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakova

**RAPORT
PËRMBLEDHËS
"2021"**





KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

K.R.M. "ÇABRATI"

Tel. +383(0)390/321 588
+383(0)390/324 034
+383(0)46 19 55 55
www.cabrati.com
e-mail: info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakova

Kushtet e Referencës.....	3
Përmbledhja e Raportit.....	3
Kronologjia e proceseve dhe aktiviteteve për vitin 2020 në KRM "ÇABRATI" SH.A.	4
Raportimet nga Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv.....	9
Spektori i Financave dhe Thesarit.....	10
Spektori i Faturimit dhe inkasimit.....	13
Spektori i Prokurimit për vitin 2021.....	14
Spektori Juridik / Administrative	16
Spektori i Burime Njerzore.....	20
Spektori i Operatives	21
Rekomandimet	215

Kushtet e Referencës

Ky raport pasqyron gjendjen reale të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave KRM "Çabрати" SH.A. Qëllimi në përmbajtje të raportit është informimi i Komisioni të Aksionarëve të KRM "Çabрати" SH.A, në lidhje me ecurinë e aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit 2021.

Përmbledhja e Raportit

Raporti përmbanë aktivitetet ekonomike, financiare dhe juridike të kompanisë në fjalë, të cilat tashmë kanë ndodhur gjatë vitit 2021, duke pasqyruar të gjitha aktivitetet në të gjitha sektorët.

Periudha raportuese (01 Janar deri me 31 Dhjetor 2021) e paraqitur si në vijim:

- Aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2021;
- Të dhënat financiare për vitin 2021;
- Investimet financiare për vitin 2021;
- Shtrirja e shërbimeve në teren;
- Analiza e faturimit dhe inkasimit shprehur në %;
- Sektori Juridik – Administrativ;
- Sektori i prokurimit;
- Sektori i burimeve njerzore – personeli;
- Sektori i operatives;

Kronologjia e proceseve dhe aktiviteteve për vitin 2021 në KRM "ÇABRATI" SH.A.

Bordi i Drejtorëve i KRM "Çabрати" Sh.A. Gjakovë, ka mbajtur takime të rregullta në baza mujore dhe takime të jashtëzakonshme sipas nevojës, ku në secilën mbledhje janë trajtuar pikat e zakonshme si kuorumi, aprovimi i pikave të rendit të ditës dhe i procesverbalit paraprak, shqyrtimi dhe miratimi i raportit të Komisionit të Auditimit dhe raportit të Kryeshefit Ekzekutiv.

Gjatë vitit 2021, Bordi i Drejtorëve ka mbajtur gjithsej 16 takime, përfshirë edhe takimin me Komisionin Komunal të Aksionarëve.

Bordi i Drejtorëve i KRM "Çabрати" Sh.A, në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, si dhe Statutin e Kompanisë, ka shqyrtuar çështjet afariste të Ndërmarrjes dhe ka aprovuar projekte, plane, raporte dhe kërkesa të parashtruara gjatë takimeve.

Më poshtë është paraqitur kronologjia nga takimet e zhvilluara dhe vendimet që janë marrë.

Mbledhet e Bordit të Drejtorëve të KRM "Çabрати" SH.A

Takimi me datë: 15.02.2021

1. **VENDIM:** SHFUQIZOHET Vendimi i Bordit të Drejtorëve të KRM "Çabрати" Sh.A., me nr. 001/20, i datës 22.01.2020, me të cilin z. Berat Hadri shkarkohet nga pozita e Kryeshefit Ekzekutiv. Me shfuqizimin e këtij vendimi z. Hadri kthehet në vendin e punës, në pozitën që kishte si Kryeshef Ekzekutiv i KRM "Çabрати" Sh.A. Gjakovë.
2. **VENDIM:** SHFUQIZOHET Vendimi i Bordit të Drejtorëve të KRM "Çabрати" Sh.A. me nr. protokoll 1806, i datës 01.12.2020, me të cilin z. Behar Ferizi emërohet si Kryeshef Ekzekutiv, sipas konkursit publik të datës 21.09.2020. Me shfuqizimin e këtij vendimi z. Ferizi, i ndërpritet marrëdhënia e punës si Kryeshef Ekzekutiv i KRM "Çabрати" Sh.A. Gjakovë.

APROVOHET: Rregullorja e brendshme për "Organizimin dhe Sistematizimin e vendeve të punës".

Takimi me datë: 26.02.2021

3. **VENDIM:** Shkarkohet nga pozita e Kryeshefit Ekzekutiv z. Berat Hadri, i riemëruar me vendimin nr. 275, të datës 15.2.2021.

Takimi me datë: 12.03.2021

4. **VENDIM:** Bordi i Drejtorëve unanimisht u pajtuan që të angazhohet një avokat i cili do të merret me rastin e z. Berat Hadri. Për këtë rast do të përgatitet i gjithë materiali, me të gjitha shkeljet e gjetura, të bëra nga Kryeshefi Ekzekutiv i shkarkuar me qëllim të ngritjes së kallëzimit penal.

MIRATOHET "Rregullorja e Pagave" pa Shtojcen Nr.1. Ndërsa propozimi për nivelizim të pozitave të punës dhe pagave do të shqyrtohet në mbledhjen e rregullt të radhës së BD.

Takimi me datë: 16.04.2021

MIRATOHET me plotësimet/ përmirësimet e kërkuara nga BD "Raporti vjetor i aktiviteteve të Kryeshefit Ekzekutiv për vitin 2020"

MIRATOHET me votim unanim pa asnjë kundërshtim propozimi i KE duke u bazuar në gjendjen dhe stabilitetin financiar të Kompanisë, dhe përmes këtij miratimi KE mund të vazhdojë me procedimin dhe ekzekutimin për ndarjen e këtyre mjeteve financiare prej 50 euro për punëtorët e Kompanisë, si shpërblim dhe stimulim për punën dhe angazhimin që kanë treguar gjatë vitit 2021.

RREGULLORET E BRENDSHME TË MIRATUARA GJATË VITIT 2021.

- Rregullorja e brendshme për "Organizimin dhe Sistematizimin e vendeve të punës".
- "Rregullorja e Pagave" pa Shtojcen Nr.1.
- Rregullorja për Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale".
- "Shtojca Nr.1 mbi Rregullat për Përcaktimin e Pagave të Punonjësve të KRM "Çabratit" Sh.A. Gjakovë".

Mbledhet e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në të KRM "Çabratit" SH.A

Komiteti i Auditimit gjatë vitit 2021, ka mbajtur gjithsej gjashtë (6) takime. Gjatë secilit takim është prezantuar dhe miratuar rendi i ditës, pastaj miratimi i procesverbalit paraprak, prezantimi dhe miratimi i raportit të Zyrtarit Kryesor Financiar, si dhe çështje tjera të ndryshme, vendime, miratime propozime për BD etj.

Më poshtë është paraqitur shkurtimisht kronologjia për secilin takim veç e veç, të Komitetit të Auditimit, për vitin 2021.

Takimi me datë: 02.02.2021

Kërkesë e Komitetit të Auditimit: meqenëse ende nuk kemi një Auditor të Brendshëm, Komisioni i Auditimit është duke e kryer punën e Auditorit duke kërkuar raporte drejtpërdrejtë nga Menaxherët e Sektorëve të Kompanisë, me qëllim të përmbledhjes së raporteve vjetore të punës për vitin 2021.

Nga ZKF është paraqitur Raporti nr. 1 mbi numrin e shfrytëzuesve të shërbimeve dhe ecurinë e faturimit dhe inkasimit për muajin nëntor dhe dhjetor 2020, si dhe totalin për vitin 2020, si dhe

Raporti nr. 2 Pasqyra e shpenzimeve tjera operative sipas raportit për muajin 10,11,12 /2020.

Miratohet: Raporti i Zyrtarit Kryesor Financiar për muajin 10, 11, 12 /2020.

Komisioni i Auditimit, duke konsideruar si të nevojshëm pozitën e Auditorit të Brendshëm në Kompani propozon që të shpallet konkursi për Auditor të Brendshëm. Prandaj pas diskutimit të kësaj pike Komisioni i Auditimit mori këtë vendim:

VENDIM: Të shpallet konkurs publik për pozitën Auditor i Brendshëm i KRM "Çabрати" SH.A. Gjakovë. Konkursi të publikohet prej datës 4 shkurt 2021 deri më 5 mars 2021 (me kohëzgjatje 30 ditë).

Takimi me datë: 08.03.2021

Prezantimi i Raportit nr. 1 Financiar për janar & shkurt (nga - ZKF); Dhe Raporti nr. 2 Pasqyra e shpenzimeve tjera operative sipas raportit për shpenzimet e muajit janar në krahasim me muajt paraprak.

Miratohet: Raporti i Zyrtarit Kryesor Financiar Janar 2021

U diskutua faturimi i rasteve të varrimit të kufomave nëpër fshatrat e Komunës së Gjakovës, për vdekjet nga Covid-19.

ZKF ka sqaruar se për këto raste e kemi faturuar deri më tani Komunën, por kemi pranuar përgjigje negative nga komuna. Megjithatë Faturat janë dorëzuar në komune por deri më tani nuk është bere asnjë pagese nga Komuna. Kemi të bëjmë me 4 fatura për varrime me covid-19 në fshatrat e Komunës së Gjakovës, ku në total janë 6,222.00 euro.

KAB propozoi që kjo pike e rendit të ditës të diskutohet edhe në mbledhjen e BD dhe të dalim me një përfundim apo vendim për zgjidhjen e këtij problemi për të ardhmen.

Takimi me datë: 02.04.2021

Prezantimi i Raportit nr. 1 Financiar për muajin shkurt 2021 (nga - ZKF); dhe

Anulohet konkursi i datës 04.02.2021. Kryesuesi deklaroi se jemi vonuar në këtë çështje për shkak se nuk kemi pas kuorum për vazhdimin e këtij procesi sepse një anëtar i Komisionit është në gjendje jo të mirë shëndetësore. Nëse komisioni i Auditimit kemi pritë që nëse do t'i përmirësohet gjendja shëndetësore, por duke e parë se nuk ka përmirësim atëherë jemi të detyruar që sot të dalim me një njoftim për kandidatët dhe publikun, përmes së cilit i njoftojmë se për shkak të mungesës së kuorumit të komisionit të auditimit (komisionit përzgjedhës) anulohet konkursi i datës 04.02.2021. Konkursi do të rishpallet sapo të plotësohet numri i anëtarëve të Komisionit të Auditimit (komisionit përzgjedhës).

Raporti nr. 2 me shpenzimet krahasuese, Pasqyra e shpenzimeve tjera operative sipas raportit për muajin 01 dhe 02/2021.

Miratohet: Raporti i Zyrtarit Kryesor Financiar - Shkurt 2021

Takimi me datë: 11.06.2021

Prezantimi i Raportit nr. 1 financiar mars-prill (Nga – ZKF). Dhe

MIRATOHET "Rregullorja për Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale".

MIRATOHET "Shtojca Nr.1 mbi Rregullat për Përcaktimin e Pagave të Punonjësve të KRM "Çabрати" Sh.A. Gjakovë".

Takimi me datë: 04.06.2021

MIRATOHET - Raporti vjetor 2020 i përgatitur nga Bordi i Drejtorëve, KRM "Çabрати" Sh.A. Gjakovë.

Takimi me datë: 29.06.2021

5. **VENDIM:** Krijohet grupi punues i cili do të merret me hartimin e rregullores së brendshme për "Procedurat e Faturimit dhe Inkasimit në KRM "Çabрати" Sh.A. Gjakovë".
6. **VENDIM:** Kujtim Qela, me pozitë pune Zyrtar Kryesor i Financave dhe Thesarit në KRM "ÇABRATI" Sh.A., do të vazhdojë të jetë si Ushtrues i Detyrës në pozitën e njëjtë deri sa të realizohet rekrutimi i rregullt sipas konkursit publik për këtë pozitë.

Takimi me datë: 28.09.2021

7. **VENDIM:** Lejohet shitja e Aseteve të papërdorshme të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Çabрати" Sh.A. Gjakovë.
Shitja e Aseteve të realizohet sipas procedurës së prokurimit dhe ankandit publik.
Obligohet dhe autorizohet Kryeshefi Ekzekutiv për vazhdimin e mëtutjeshëm të këtij procesi sipas procedurave ligjore.

MIRATOHET, me votim unanim nga të gjithë anëtarët e Bordit të Drejtorëve, rregullorja për Procedurën e Faturimit dhe Arkëtimit në KRM "Çabрати" Sh.A. Gjakovë.

8. **VENDIM:**

Me votim unanim nga të gjithë anëtarët e Bordit të Drejtorëve, u vendos që Valbona Dushi, me pozitë pune Certifikuese në KRM "ÇABRATI" Sh.A., caktohet si Ushtruese e Detyrës në pozitën e Zyrtares Kryesore Financiare, për një kohë të caktuar, apo deri sa të kryhet rekrutimi i rregullt sipas konkursit publik për këtë pozitë.

9. **VENDIM:**

- Të shpallet konkursi për pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar të KRM "Çabрати" Sh.A., Gjakovë.
- Konkursi të shpallet me datë 04.10.2021 në të dy gjuhët zyrtare (Shqip; Serbisht), në kohëzgjatje prej 30 ditësh kalendarike, në njërën nga gazetatat ditore, në uebfaqen e Ndërmarrjes dhe të Komunës së Gjakovës.
- Nga Sekretari i Kompanisë kërkohet që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, të publikohet konkursi sipas dispozitave ligjore në fuqi, duke u bazuar në dispozitivin e këtij vendimi.

Takimi me datë: 30.09.2021

10. **VENDIM:** me votim unanim nga të gjithë anëtarët e Bordit të Drejtorëve, u vendos që:

- Autorizohet ndryshimi i Statutit të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Çabrati" Sh.A. Gjakovë, adresa: Rr "Mazllum Lakuci" p.n, me numër Unik Identifikues 811299165.
- Pjesa e ndryshuar e Statutit (Neni 21 Bordi i Drejtorëve) dorëzohet së bashku me vendimin.

Personi i autorizuar për të nënshkruar dhe dorëzuar në zyrën e regjistrimit (në ARBK), ndryshimet e statutit, është Sekretari i Kompanisë Besnik Avdiu.

Takimi me datë: 26.10.2021

- **AUTORIZIM:** Me të cilin Autorizohet z. Behar Ferizi nga Gjakova, me numër të letërnjoftimit 1002895192, me pozitë pune Kryeshef Ekzekutiv në KRM "ÇABRATI" Sh.A. Gjakovë, që me autorizim të plotë dhe pa asnjë kufizim, të ndërmarrë veprime në emër dhe për llogari të Kompanisë "ÇABRATI" Sh.A, konkretisht të mund të kryej të gjitha transaksionet financiare, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në hapje, tërheqje, transfere, deponime etj.
- Ky autorizim i'u dërgohet të gjitha Bankave gjatë kryerjes së procedurave financiare. Autorizimi lëshohet për kohë të pacaktuar dhe i njëjti vlen deri në revokimin me shkrim nga ana e autorizuesit.

Takimi me datë: 25.11.2021

- **MIRATOHET** Biznes Planit 2022, nga të gjithë anëtarët e Bordit të Drejtorëve, me plotësimet dhe rekomandimet e theksuara nga ky takim.

11. **VENDIM:** Pas shqyrtimit të aplikacioneve të kandidatëve për pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe Thesarit, dhe pas kryerjes së vlerësimit është konstatuar se prej katër (4) kandidatëve që kishin aplikuar për pozitën e cekur më lartë, vetëm një (1) kandidat i plotëson kushtet/ kriteret e kërkuara për këtë pozitë sipas procedurave të vlerësimit dhe sipas udhëzimit administrativ nr.07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, përkatësisht neni 6, paragrafi 5, pika 5.1 të këtij udhëzimi.

Andaj bazuar në këtë, ANULOHEM konkursi i datës 04.10.2021.

Pas anulimit të konkursit të shpallur me datë 04.10.2021, i njëjti do të përsëritet/ rishpallet brenda afatit prej 8-të ditësh.

Konkursi të rishpallet me datë 30 nëntor deri më 14 dhjetor 2021, në ora 16:00.

Takimi me datë: 17.12.2021

Hapja e aplikacioneve të kandidatëve që kanë aplikuar për pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar në KRM "Çabrati" Sh.A. Gjakovë, sipas konkursit të rishpallur me datë 30.11.2021.

BORDI I DREJTORËVE, pas shqyrtimit të aplikacioneve të kandidatëve për pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe Thesarit, dhe pas kryerjes së vlerësimit konstatuan se prej pesë (5) kandidatëve që kishin aplikuar për pozitën e cekur më lartë, tre (3) kandidatë i plotësojnë kushtet/ kriteret e kërkuara për këtë pozitë.

Andaj në bazë të procedurave të vlerësimit dhe sipas udhëzimit administrativ nr. 07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, përkatësisht neni 9, paragrafi 5, janë plotësuar kushtet për procedimin më tutje të rekrutimit për pozitën e ZKF dhe pas afatit për parashtrimin e ankesës së kandidatëve të pakënaqur, bëhet ftesa e listës së ngushtë për testin me shkrim në datën e caktuar nga Komisioni Përzgjedhës.

Takimi me datë: 22.12.2021

Propozimi i Kryeshefit Ekzekutiv, për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 50 € (pesëdhjetë euro), për të gjithë punëtorët e KRM "Çabrati" Sh.A. Gjakovë.

Raporti 2: Pasqyra e shpenzimeve tjera operative sipas raportit për muajin 02; 03; 04 /2021.

Miratohet: Raporti i Zyrtarit Kryesor Financiar për muajit 02, 03, 04 /2021.

Takimi me datë: 13.08.2021

Prezantimi i Raportit nr. 1 financiar maj – qershor 2021 (Nga – ZKF). dhe

Raporti nr. 2 Pasqyra e shpenzimeve tjera operative sipas raportit për muajin 04, 05, 06 /2021.

Miratohet: Raporti i Zyrtarit Kryesor Financiar për muajit 04, 05, 06 /2021.

Takimi me datë: 16.11.2021.

Raporti nr. 1 i pasqyrave financiar për muajin: korrik, gusht, shtator, tetor 2021. Dhe

Raporti 2 - Pasqyra e shpenzimeve tjera operative sipas raportit për muajit 08, 09, 10 /2021.

Miratohet: Raporti i Zyrtarit Kryesor Financiar për muajit 08, 09, 10 /2021

Raportimet nga Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv

Gjatë vitit 2021, nga zyra e Kryeshefit Ekzekutiv, i cili ka qenë pjesëmarrës në 8 mbledhjet e rregullta të Bordit të Drejtorëve, ku është raportuar për ecurinë, aktivitetet dhe zbatimin e planeve të punës bazuar në Biznes Planin e Kompanisë për vitin 2021, ku të gjitha raportet në mënyrë unanime janë miratuar nga anëtarët e Bordit të Drejtorëve.

Gjithashtu në mbledhjen Vjetore të mbajtur në qershor 2021, është miratuar raporti nr. VI i përgatitur nga Kryeshefi Ekzekutiv.

- Vendime të ndërmarra nga Kryeshefi Ekzekutiv për vitin raportues janë gjithsej 162 vendim.
- Kontratat e nënshkruara gjatë vitit 2021 janë:
 - ✓ Kontratë për kryerje të shërbimeve postare e lidhur ndërmjet KRM “Çabratit” dhe Posta e Kosovës;
 - ✓ Marrëveshje për pagesën e anëtarësisë në asociacionin PAMKOS;
 - ✓ Kontratë për abonim në shërbimet e Telekomit të ofruara nga Ipko për biznese;
 - ✓ Marrëveshje për shërbimin grumbullimin dhe transportimit të mbeturinave në kompleksin memorial “Beteja e Koshares”;
 - ✓ Marrëveshje për mbajtjen e gjelbërimit dhe mbjelljen e fidanëve të drunjëve dekorativ dhe luleve lidhur ndërmjet KRM “Çabratit” dhe Komunës së Gjakovës;

- ✓ Kontratë mirëmbajtja e hapësirave të jashtme në oborrin e spitalit lidhur ndërmjet KRM "Çabрати" dhe Spitali i përgjithshëm Isa Grezda;
- ✓ Kontratë mirëmbajtja e hapësirave të jashtme në oborrin e QSHM lidhur ndërmjet KRM "Çabрати" dhe Qendra e shëndetit mendorë;
- ✓ Marrëveshje për shërbimet televizive, publikim shpallje dhe njoftime për shërbime lidhur ndërmjet KRM "Çabрати" dhe TV Syri;
- ✓ Shtojcë kontratë mbi shërbimet e mirëmbajtjes të produkteve softuerike të sistemit të centralizuar për menaxhimin e financave dhe kontabilitetit lidhur ndërmjet KRM "Çabрати" dhe Informatika Computers Sh.P.K;
- ✓ Kontratë për shërbimet e telefonisë mobile, fikse dhe internetin e lidhur ndërmjet Telekomit të Kosovës dhe KRM "Çabрати" SH.A;
- ✓ Memorandum Mirëkuptimi për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale lidhur ndërmjet Komunës Gjakovës dhe KRM "Çabрати" SH.A;
- ✓ Marrëveshje bashkëpunimi për mirëmbajtjen e auto rrugëve lidhur ndërmjet Komunës së Gjakovës dhe KRM "Çabрати".SH.A;
- ✓ Kontratë shërbimi lidhur ndërmjet KRM "Çabрати"SH.A dhe Kompanisë për menaxhimin e deponive në Kosovë (KMDK);

➤ Rezultatet e arritura gjatë implementimit të projekteve dhe iniciativave të ndryshme.

- ✓ Përfundimi i Oborrit Riciklues;
- ✓ Pastrimi total i Stacionit Transfer;
- ✓ Shtrirja e shërbimit prej 68% sa ka qenë në vitin 2020 ndërsa në vitin 2021 ka arritur shtrirjen e shërbimeve 100% ku janë integruar në shërbime edhe 22 fshatra;
- ✓ Rritja e Faturim-Inkasimit në 30%;
- ✓ Tërheqja e mbi 50 deponive ilegale;
- ✓ Uniforma të reja për të gjithë punëtorët e pastrimit dhe mirëmbajtjes.

Sektori i Financave dhe Thesarit

Objektiv kryesor dhe primar i Sektorit Financiar është menaxhimi i mirë i burimeve financiare, ku menaxhimin dhe planifikimi i saktë i bërë gjatë vitit 2021 ka shënuar një stabilitet financiarë përkundër investimeve kapitale të bëra gjatë vitit., kësaj i ka kontribuar inicimi i procedurave përmbartimore nga përmbartuesit privat për klientët me borxhe të akumuluar si dhe subvencionin nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit në vlerë prej 400,000 Euro për largimin e mbeturinave nga statcioni transfer.

Kompania Rajonale e Mbeturinave "Çabрати" Sh. A ka kontraktuar kompaninë për Auditimin e Pasqyrave financiare për vitin 2021, të cilat do të dorëzohen në muajin prill 2021

1	RRJEDHA E PARASE SE GATSHME NGA AKTIVITETE OPERATIVE	2021	2020
2	Pranimi i parave te gatshme nga konsumatorët	1,519.999.23	1,322.860.16
3	Paratë e paguara furnizuesve dhe te punësuarve	-1,430.468.08	-1,372.350.01
4	Paratë e gatshme qe gjenerohen nga veprimet (2+3)	8,9531.15	-4,9489.85
5	Interesi i paguar		
6	Tatimi mi fitim i paguar	-25, 183.62	
7	Paratë e gatshme neto nga aktivitetet operative (4+5+6)	6,4347.53	-4,,9489.85
8	RRJEDHA E PARASE SE GATSHME NGA AKTIVITETE INVESTIVE		
9	Blerja e mjeteve themelore dhe aktivitete tj. investuese	-8,850.00	
10	Shitja e mjeteve themelore dhe aktivitet tj. investuese		
11	Interesi i pranuar		
12	Dividenda e pranuar		
13	Paratë neto te përdorura ne aktivitetet investive (9+10+11+12)	-8,850.00	
14	RRJEDHA E PARASE SE GATSHME NGA AKTIVITETE FINANCUESE		
15	Lëshimi i aksioneve ne kapital dhe aktivitete tj. financuese		
16	Rezultati nga huamarrja		
17	Pagesa e detyrimeve për lizing dhe aktivitete tj. Financuese		
18	Dividenda e paguar		
19	Deponimi pronarit		
20	Tërheqje e pronarit		
21	Paratë e gatshme te përdorura ne aktivitetet financuese (15 deri 20)		
22	Neto ngritjet / zbritjet ne para te gatshme dhe ekuivalentet (7+13+21)	55,497.53	-49,489.85
23	Paratë e gatshme ne fillim	53,957.65	103,447.50
24	Paratë e gatshme ne fund te periudhës (22+23)	109,455.18	53,957.65
* Sqarim i zërave:			
2 - Qarkullimi i mjeteve financiare ne arke dhe banka			
3 - Pagesat e furnitorëve dhe pagat e punëtorëve përmes arkës dhe bankave.			
6 - Tatimi mbi fitim i paguar			
7 - Blerja e mjeteve themelore (Kamion)			
Te hyrat ne total për vitin 2021 janë ne vlere prej		1,528,301.27€	

Shpenzimet ne total për vitin 2021 janë ne vlere prej	1,382,431.71€
---	---------------

➤ Shpenzimet e derivative (benzin, nafte dhe vajra) për periudhen Janar-Dhjetor 2021.

Muaj:	Nafte	Benzin	Vajra
Janar	8,461.32	107.35	278.52
Shkurt	8,532.79	101.05	410.18
Mars	10,874.29	127.18	360.34
Prill	10,766.07	258.90	491.95
Maj	11,278.44	379.18	669.02
Qershor	12,437.90	340.75	283.90
Korrik	14,043.53	199.87	202.45
Gusht	14,007.03	217.46	29.56
Shtator	14,645.90	219.99	2,442.58
Tetor	13,990.20	192.93	44.07
Nentor	13,435.35	274.19	1,980.34
Dhjetor	14,513.02	200.82	709.11
TOTALI	146,985.84	2,619.67	7,902.02

Sqarim: Totali i shpenzimeve të derivateve: 157,507.53 €

➤ Shpenzimet për riparimin e kamionëve për vitet 2020 dhe 2021

Shpenzimet e riparimit te kamionëve Shpenzime për pikje te gomave Shpenzimet për Autogoma

Muaji	Vlera ne € / 2020	Vlera ne € / 2021	Vlera ne € / 2020	Vlera ne € / 2021	Vlera ne € / 2020	Vlera ne € / 2021
Janar	3,651.86	2,473.87	59.33	211.86	370.99	368.99
Shkurt	1,788.83	1,523.40	148.31	138.65	990.03	578.02
Mars	5,269.42	3,187.50	55.08	60.00	757.66	4,718.98
Prill	2,568.68	2,775.37	97.46	-	763.41	5,468.97
Maj	1,065.98	5,127.58	156.78	-	2,535.50	-
Qershor	4,798.37	6,220.06	148.30	697.45	50.00	663.73
Korrik	2,795.93	3,838.89	156.78	320.34	-	355.93
Gusht	1,935.27	3,595.59	76.27	-	135.60	14.00
Shtator	3,014.57	4,803.80	161.02	682.20	644.20	290.85
Tetor	2,142.53	5,129.50	-	964.41	660.56	1,067.80
Nentor	6,756.41	5,969.01	67.80	-	192.60	1,610.17

Dhjetor	2,059.78	7,233.38	-	914.41	11.86	-
TOTALI	37,847.63	51,877.95	1,127.13	3,989.32	7,112.41	15,137.44

Totali i shpenzimeve për vitin 2020: 46,087.17€ ndërsa për vitin 2021: 71,004.71€

➤ **Shpenzimet e perfaqesimit dhe reprezentacionit Janar-Dhjetor 2021**

Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Totali €
126.97	80.91	662.11	260.20	296.30	332.65	378.49	272.47	171.82	206.34	222.71	1,394.41	4,405.38

➤ **Pagesat ne Kesh nga Arka per vitin 2021**

Totali i pagesave Kesh nga arka për vitin 2021 është ne vlerë prej 27,379.56€

Sektori i Faturimit dhe inkasimit

➤ **Struktura dhe numri i klientëve të shërbyer gjatë vitit 2021**

Viti	Amvisëritë	Bizneset i vogel	Biznes i madh	Institucione	Totali
2020	12,524	2,066	161	74	14,825
2021	14,213	2,223	212	77	16,802

Numri i paraqitur i klientëve të shërbyer është raporti i numrit të klientëve të rinjë të raportuar nga Sektori i Shitjes.

➤ **Faturimi dhe inkasimi për vitin 2020, i shprehur në vlerë dhe përqindje (%)**

Kategoritë	Faturimi	Inkasimi	%
Amvisëri	785,801.96€	788,551.32€	100.35 %
Biz. Vogel	174,339.71€	173,028.92€	99.25 %
Institucione	463,833.92 €	336,006.85€	72.44%
Biz. Madh	133,895.65€	119,855.41€	89.51%
Shërbime Varrimi	56,336.34€	56,336.34€	100%
Shërbime tjera	3,458.8€	3,471€	100.35%
Totali	1,617.666.4 €	1,477.249.84€	91.32

➤ **Numri i klientëve të ri të shërbyer gjatë vitit 2021**

- ✓ Amvisëri **1,689** konsumatorë të rinj;
- ✓ Biznes i vogël **157** konsumator të rinj;
- ✓ Biznes i madh **51** konsumator të rinj;
- ✓ Institucione **3** konsumator të rinj;
- ✓ Totali për vitin 2021, **1,900** konsumator të rinj.

Sektori i Prokurimit për vitin 2021

Zyra e prokurimit për çdo vit kalendarik dorëzon planifikimin përfundimtar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit.

Zyra e prokurimit, për çdo vit kalendarik duhet të përgatisë dhe dorëzojë në Komisionin Rregullator të Prokurimit Publik një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik në KRM “ÇABRATI” Sh.A. për atë vit kalendarik.

PLANIFIKIMI PROKURIMIT 2021		25 aktivitete
Furnizime		19
Shërbime		5
Punë		1
VLERA TOTALE E PLANIFIKIMEVE		368,564.47 Euro
Furnizim		323,932.28 Euro
Kontratë për shërbime		17,632.19 Euro
Kontratë për punë		27,000.00 Euro
AKTIVITETET E PLANIFIKIMIT TE REALIZUARA		
Furnizim		7
Shërbime		3
Punë		
VLERA E PLANIFIKIMIT TE REALIZUAR		SIPAS VLERES SE PARASHIKUAR
Furnizim		62,120.18 Euro
Shërbime		3,482.04 Euro
Punë		
AKTIVITETET E PROKURIMIT TE PAREALIZUARA		SIPAS PLANIFIKIMIT
Furnizim		11
Shërbime		2
Punë		1
VLERA E AKTIVITEVE TE PROKURIMIT TE		PAREALIZUARA SIPAS PLANIFIKIMIT
Furnizim		247,312.10 Euro
Shërbime		14,150.15 Euro
Punë		27,000.00 Euro
AKTIVITETET E PROKURIMIT TE		PAPLANIFIKUARA TE REALIZUARA
Furnizim		5

Shërbime	3
Punë	
VLERA E AKTIVITEVE TE PROKURIMIT TE PAPANIFIKUARA TE REALIZUARA SIPAS VLERES SE PARASHIKUAR	
Furnizim	15,770.00 Euro
Shërbime	28,100.00 Euro
Punë	

NUMRI I KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA	16
VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA	73,458.63Euro
KONTRATAT E NËNSHKRUARA SIPAS LLOJIT TE	PROKURIMIT
Kontratë për furnizim/11	42,804.64 Euro
Kontratë për shërbime/5	30,653.99 Euro
Kontratë për punë/0	/
KONTRATAT E NËNSHKRUARA SIPAS VLERËS SË	PARASHIKUAR PROKURIMIT
Vlerë të madhe/0	0
Vlerë të mesme/4	5,4614.15 Euro
Vlerë të vogël/6	14,955.88 Euro
Vlerë minimale/6	3,888.60 Euro
KONTRATAT E NËNSHKRUARA SIPAS	PROCEDURAVE TË PROKURIMIT
Procedurë e hapur	3
Procedurë e kuotimit të çmimeve	6
Procedurë e vlerës minimale	6
Procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë	1

NUMRI I KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA	16
VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA	125,232.74 Euro
KONTRATAT E NËNSHKRUARA SIPAS LLOJIT TE	PROKURIMIT
Kontratë për furnizim/11	117,030.20 Euro
Kontratë për shërbime/5	8,202.54 Euro
Kontratë për punë	/
KONTRATAT E NËNSHKRUARA SIPAS VLERËS SË	PARASHIKUAR TË PROKURIMIT
Vlerë të madhe/0	
Vlerë të mesme/4	
Vlerë të vogël/10	
Vlerë minimale/2	
KONTRATAT E NËNSHKRUARA SIPAS	PROCEDURAVE TË PROKURIMIT
Procedurë e hapur	4
Procedurë e kuotimit të çmimeve	10
Procedurë e vlerës minimale	2

Sektori Juridik / Administrativ

Bordi i Drejtorëve nëi KRM "Çabрати" Sh.A, në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, si dhe Statutin e Kompanisë, ka shqyrtuar çështjet afariste të Ndërmarrjes dhe ka nxjerr 11 /njëmbëdhjetë/ vendime dhe 11 njëmbëdhjetë / miratime, me të cilat ka aprovuar rregullore, plane, raporte dhe kërkesa të parashtruara gjatë takimeve

- ✓ Lëndët e iniciuara në procedurë përmbarimore gjatë vitit 2021 duke krahasuar me vitin paraprak:

Lloji i konsumatorit	Nr. Lëndëve iniciuara	Lloji i konsumatorit	Nr. Lëndëve iniciuara
Viti	2020	Viti	2021
✓ Amvisëri	119	✓ Amvisëri	210
✓ Biznes i vogël	33	✓ Biznes i vogël	46
✓ Biznes i madh	23	✓ Biznes i madh	23
✓ Institucione	0	✓ Institucione	0
✓ TOTAL	175	✓ TOTAL	266

Në total gjatë vitit 2021, 55 lëndë janë fituar, plotësisht apo pjesërisht, ndërsa 13 lëndë janë të humbura.

Kontestet Gjyqësore gjatë vitit 2021

- ✓ **Rasti i parë:** janë tre konteste me "Lonis Pub" gjegjësisht Fisnik Bakija si pronar i kësaj firme, dy aktakuza penale për uzurpim dhe pengim personave zyrtar të ngritura nga Prokuroria e Shtetit që për njërin është liruar, e tjetrën është dënuar. Mirëpo me ankesë në shkallë të dytë nga i akuzuari, Gjykata e Apelit ka kthyer lëndet në rigjykim në shkallën e parë, dhe ato i ka bashkuar si një e vetme. Në vitin 2019 gjykata e shkalles parë e ka liruar nga aktakuza Fisnik Bakin. Pastaj nga Prokuroria e Shtetit dhe KRM "Çabрати" Sh.A., është ushtruar Ankesë në Gjykatën e Apelit dhe presim si do të përfundoj ky kontest. Kurse kemi edhe një kontest civil për pretendim të pronës të kompanisë sonë, padi e ushtruar Fisnik Bakia. Këtë kontest civil

ne si kompani përmes avokatit e kemi fituar rastin në shkallë të parë. Pala paditëse ka ushtruar ankesë në shkallë të dytë, por që Gjykata e Apelit e ka vërtetuar Aktgjykimin e shkallës parë. Rasti është ende i hapur në proces gjyqësor dhe me datë 24.02.2022 është caktuar seanca e radhës pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë.

- ✓ **Rasti i dytë** është rasti **Civ. 434/12** ku paditës është një ish punëtor **Afrim Shala** dhe kërkon rreth 60 mijë Euro, si kompensim dëmi pasi i ka vdekur një fëmijë në Stacionin Transfer. Rasti vazhdon në Gjykatë. Rasti është i ndjeshëm i komplikuar dhe i trashëguar nga viti 2009. Ky rast është fituar nga Kompania në Gjykatën Themelore në Gjakovë me 2016, pala paditëse ka bërë ankesë në Apel. Gjykata e Apelit me dt. 01.11.2021 ka marrë Aktvendim me të cilin e Prishë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë të datës 10.11.2016, dhe lënda është kthyer në ri-procedurë.
- ✓ **Rasti i tretë** është rasti nga vitit 2016 **C. Nr. 199/16**, Kompania ka ngritur padi për shqyrtim të rastit që përmes padisë civile kërkon nga Gjykata zgjidhjen e kontestit **për objektin e Operativës**, nëse eventualisht e humbim rastin, pasojat mund të jenë të larta nga aspekti material. Arsyeja është **se AKP** mund të pretendojë pagimin e qirasë për vitet e kaluara. Rasti ende është i pa përfunduar.
- ✓ **Rasti i katërt** është rasti **C. Nr. 137/2011 – Kontest juridik i trashëguar nga 2011 me AKP-në**, e cila pretendon se është pronare e pronës “Fusha e tyrbes”. Për këtë çështje duhet të ndërmerren disa veprime administrative nga ana e Komunës për ta sqaruar situatën, kjo procedurë duhet të kryhet përmes Drejtorisë së Urbanizmit dhe Kadastër apo edhe punëve inspektuese.
- ✓ **Rasti i pestë** është **C.nr. 280/2015 – Kontest Pune Agron Doli**. Ky rast është fituar në shkallën e parë nga pala paditëse. Kompania ka bërë ankesë në Gjykatë të Apelit. Në janar të vitit 2021 Gjykata e Apelit nxjerrë Aktvendim me të cilin e prishë Aktvendimin e shkallës së parë dhe rastin e kthen në rigjykim. Tani çështja është ende në proces në gjykatën e shkallës së parë.
- ✓ **Rasti i gjashtë** është **C. Nr. 553/ 17 – Kontest pune Nora Gola** – Ky rast është fituar në shkallë të parë nga paditësja Nora Gola. Kompania ka parashtruar ankesë në Apel në vitin 2018. Gjykata e Apelit me datë 27.10.2021 me Aktvendim e Prishë Aktgjykimin e Gjykatës

Themelore në Gjakovë të datës 04.02.2019 dhe lënda kthehet në rigjykim dhe rivendosje. Ende në proces.

- ✓ **Rasti i shtatë është Civil –Përmbarimor me ZRrUM – Rast i trashëguar që nga viti 2012**, rasti ka shkuar nëpër disa Gjykata dhe përfundimisht është kthyer në Gjykatën Themelore në Gjakovë me Propozim për Përmbarim shumë 31,000.00 €. Por ka ankesë për parashkrim të gjysmës së borxhit, dhe fakte se edhe mund të evitohet borxhi pasi paditësja si autoritet nuk ka vepruar sipas obligimeve të veta ligjore, ka lejuar operator privat të operojnë në zona tona të shërbimit, gjë që neve na kanë shkaktuar humbje financiare dhe pamundësi të pagesave të këtij borxhi. Lënda është ende në proces dhe nuk është caktuar se cila gjykatë ka kompetente për shqyrtimin e saj.
- ✓ **Rasti i tetë C. Nr. 287/19 është një Padi nga Agim Buza**. Objekt i padisë është për anulimin e vendimit për shkëputje të marrëdhënies së punës nga KRM “Çabrati” Sh.A. Në këtë rast të punësuarit i është ndërprerë marrëdhënia e punës pas skadimit të afatit të kontratës në përputhje me Ligjin e Punës, këtë e ka vërtetuar edhe Inspektorati i Punës përmes vendimit. Por pala ka ushtruar padi edhe në Gjykatën Themelore Gjakovë për të provuar të drejtat e tij dhe kthimin në venin e punës. Rasti është pushuar me kërkesën e paditësit, por mund të aktivizohet kurdo që kërkohet nga paditësi apo e paditura.
- ✓ **Rasti i nëntë C. nr. 436/20, Paditësi Hashim Rraci**, cili ka ushtruar padi pranë Gjykatës Themelore Gjakovë duke kërkuar që KRM “Çabrati” Sh.A., ti paguaj borxhin në emër të 3 pagave jubilarë për 35 vite të përvojës së punës në shumën prej 1684.32 euro dhe në emër të një page mujore pas pensionimit në shumën prej 561.44 euro, në shumën e përgjithshme prej 2245.76 euro, me kamatë për vonesë prej 8 % në vit duke llogaritur nga data 22.06.2018 si datë e pensionimit të paditësit, si dhe shpenzimet procedurale. Kompania ka bërë përgjigje në padi në lidhje me këtë rast. Me datë 09.11.2021 Gjykata Themelore në Gjakovë nxjerrë Aktgjykim me të cilin Aprovohet kërkesëpadija e paditësit. Kundër këtij Aktgjykimi kemi bërë Ankesë në Gjykatën e Apelit.
- ✓ **Rasti i dhjetë C. Nr. 437/20, Paditësi Xhafer Shyti**. Paditësi ka ushtruar padi pranë kësaj Gjykatës Themelore në Gjakovë. Paditësi ka kërkuar që KRM “Çabrati” Sh.A., ti paguaj borxhin në emër të 1 page jubilarë dhe në emër të një page mujore pas pensionimit në shumën e

përgjithshme prej 721.46 euro, me kamatë për vonesë prej 8 % në vit duke llogaritur nga data e pensionimit të paditësit. Me datë 21.12.2021 Gjykata Themelore në Gjakovë nxjerrë Aktgjykim me të cilin Aprovohet kërkesëpadia e paditësit. Kundër këtij Aktgjykimi kemi bërë Ankesë në Gjykatën e Apelit.

- ✓ **Rasti i njëmbëdhjetë C.nr. 68/20. Paditës Bordi i Drejtorëve – kontest pune.** Kompania Regionale e Mbeturinave “Çabrati” Sh.A., me datën 01.10.2020, ka pranuar Aktvendimin për lëndën C.nr.68/20, për kontest pune parashtruar nga paditësit: Gazmend Tuzi, Nesrete Juniku, Sadri Lulaj dhe Besart Gashi, të cilët i përfaqëson av. Teki Bokshi, nga Gjakova. Brenda afatit ligjor kemi bërë përgjigje në padi. Paditësit përmes padisë së parashtruar me datë 21.01.2020 kan kërkuar nulimin e vendimit për shkarkimin e Bordit të Drejtorëve të KRM “Çabraqi” Sh.A. me nr.1732 të datës 14.11.2019 dhe vërtetimin e cilësisë së të punësuarve sipas marrëveshjes së datës 20.06.2018. Rasti është ende në proces në gjykatën e shkallës së parë.
- ✓ **Rasti i dymbëdhjetë Ac. Nr. 5093/20, Rasti Berat Hadri, (I PËRFUNDUAR)** pas shkarkimit nga Bordi i Drejtorëve në janar 2020 BH, ka bërë Ankesë në Inspektoratin e Punës dhe e ka fituar rastin në dy shkallët e IP-së. Pastaj i është drejtuar Gjykatës Themelore në Gjakovë me propozim përmbarimor për anulimin e vendimit të BD dhe kthimin në vendin e punës dhe e ka fituar rastin në shkallën e parë. Pas Ankesës së Kompanisë kemi pranuar edhe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit e cila ka vërtetuar Aktvendimin e shkallës së parë. Në lidhje me këtë rast Kompania ka ngritur Ankesë-Padi në Gjykatën Administrative në Prishtinë mbi kontestin e kompetencave administrative, por ende nuk kemi pranuar përgjigje nga kjo gjykatë. I njëjti ka ngritur edhe padi për Aplikimin e masës së përkohshme të sigurisë, por padia është hedhur si e pa bazuar edhe nga Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e Apelit. Rasti ka përfunduar sipas Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë CP.nr. 137/20 i datës 16.03.2021.
- ✓ **Rasti i trembëdhjetë C.nr. 165/21, Paditësi Argjent Fetahu. (I PËRFUNDUAR)** E paditura Kompania Rajonale e Mbeturinave “Çabrati” Sh.A. Gjakovë, me datë 17.05.2021 ka pranuar Aktvendimin C.nr. 165/21, lëshuar nga Gjykata Themelore Gjakovë, sipas Padisë të ushtruar nga Argjent Fetahu nga Gjakova, Rr. “Sadik Stavileci” Nr. 113, për konflikt administrativ. Brenda afatit ligjor i kemi bërë përgjigje në padi. Me datë 16.12.2021 gjatë shqyrtimit gjyqësor

paditësi me të paditurën arrijnë marrëveshje dhe paditësi e tërheqë padinë dhe rasti konsiderohet i përfunduar.

Sektori i Burime Njerzore

KRM. "ÇABRATI" Sh.A. Gjakovë, në fillim të vitit 2021 ka startuar me 138 punëtorë të rregullt dhe 3 persona të angazhuar me Kontrata në vepër, 2 MSHV, dhe 4 anëtar të Bordit Drejtorëve. Numri i të punësuarve 2021:

Në fund të vitit 2021 ka pasur gjithsejtë 152 persona që kanë qenë në listën e pagave, prej tyre:

- Punëtorë të rregullt kompania ka pasur: 145, (prej tyre 65 me kontrata me kohë të pacaktuar, dhe 80 me kontrata me kohë të caktuar.
- Punëtorë jo të rregullt: të angazhuar kohë pas kohe, me kontrata në vepër kanë qenë 2 /dy/ dhe 1 /një/ me MSHV-a, (që të 3 /tre/ personat si profesionistë).
- Anëtarë të Bordit të Drejtorëve janë: 4 /katër/ persona (të gjithë të emëruar nga Komisioni Komunal i Aksionarit).
- Punëtor të rregullt të pranuar gjatë vitit 2021 kanë qenë: 25 /njëzet e pesë/, prej tyre: 1/një/ KE (me vendim Gjykate), dhe 1 /një/ Koordinator i Autoparkut (konkurs i brendshëm); 1 /një/ Shofer me kategori "C1E", 2 /dy/Inkasant; 2 /dy/ Punëtor sigurimi - roje; 1 /një/ Certifikuese e pagesave; 1/një/ Kryepunëtor për parkun riciklues, 1 /një/ Mekanik; 1 /një/ Zyrtar i logjistikës, 1 /një/ Zyrtare për arkivim; 1 /një/ Kontroll e brendshme; 11 /njëmbëdhjetë/ punëtor fizik sezonal; dhe 1 /një/ Zyrtare Kryesore Financiare dhe Thesarit e pranuar në vitin 2021 por që punën e ka filluar në vitin 2022, (të gjithë këta të pranuar me konkurse të jashtme).
- Punëtorë të jo të rregullt, të pranuar gjatë vitit 2021 kanë qenë: 4 /katër/ persona me kontrata në vepër (1 /një/ ekspert i programit financiar, 1 /një/ ekspert për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike dhe veb faqes, 1 /një/ Shofer me kategori "C1E" dhe 1 /një/ Kontroll e Brendshme/, dhe dy persona me MSHV: 1 /një/ person si pastruese-zëvendësim i punëtores në pushim të lehonisë dhe 1 /një/ person shërbime mjekësore) të gjithë të pranuar pa konkurs, dhe një mjekë i pranuar me procedurë prokurimit me Kontratë.
- Punëtorë të rregullt të larguar gjatë vitit 2021 kanë qenë: 14 /katërmëdhjetë/, prej tyre: 1/një/ KE (shkarkim); 2 /dy/ Shoferë me kategori "C" (njëri vdekje natyrore dhe tjetri pensionim); 1 /një/ Zyrtar i logjistikës (vetë dëshirë); 1 /një/ Zyrtare për arkivim (vetë dëshirë), 1 /një/ Rojtar (vdekje natyrore); 1 /një/ u.d. Zyrtar Kryesor Financiar dhe Thesarit

(vdekje natyrore), dhe 7 /shtatë/ Punëtor fizik: (1/një/ pension, 1 /një/ skadim i kontrates, 3 /tre/ vetë dëshirë, dhe 2 /dy/ largim me Komision disiplinor).

- Punëtorë jo të rregullt të larguar gjatë vitit 2021 kanë qenë: 2 /dy/persona me MSHV (njëra Pastruese-ndërprerje, dhe tjetri Mjeku-vdekje natyrore) dhe 2 /dy/ persona me kontrata në vepër (njeri shofer dhe tjetri Kontrollë e brendshme - skadim afati).
- Struktura gjinore e të punësuarve është:
- ✓ Punëtorë të rregullt: 14 janë femra, dhe 131 meshkuj.
- ✓ Punëtorë të jo të rregullt: janë 3 /tre/, të gjithë janë meshkuj.
- ✓ Anëtarë të Bordit të Drejtorëve janë 4 /katër/, 2 /dy/ janë femra dhe 2 /dy/ janë meshkuj.

Sektori i Operatives

Edhe pse me një objekt të vjetër në Departamentin e Operativës, (pronë kjo e pa definuar ende nga Agjencia Kosovare e Privatizimit), me pajisje të vjetra mekanike dhe pajisjeve tjera, KRM "Çabрати" Sh.A, ka bërë përpjekje maksimale që të ofrojë shërbimet e grumbullimit të mbeturinave për të gjithë qytetarët e regjionit të Gjakovës. Për të arritur këto shërbime, është nevojitur edhe investime, është dashur të rigjenerojnë dhe optimalizojmë shpenzimet materiale dhe ato të resurseve njerëzore. Kjo kryesisht ka pasur të bëjë me:

- Modernizmin e pajisjeve dhe mjeteve tjera teknike, (kamionët e rinj, pajisjet e reja).
- Modernizimin e Autoparkut, Oficinës (krijimi i kushteve për riparimin, servisimin dhe rregullimin e kamionëve, nuk kemi arritur ta plotësojmë për shkaqe të krijuara objektive dhe subjektive që e kanë përcjellë kompaninë dhe kanë qenë pengesë).
- Ofrimin e kushteve minimale për punë, (mbrojtjen në punë, furnizimin me rroba dhe këpucë për periudhat e dimrit dhe për mbrojtje kundër pandemisë Covid -19).
- Angazhimin e personelit menaxhues në aplikimin/ fitimin e tenderëve të rinj, projekteve dhe granteve të reja të cilat si qëllim kanë rritjen e qëndrueshmërisë së kompanisë.
- Përcaktimin e indikatorëve matës në lidhje me performancën e personelit operativ dhe atij menaxhues.
- KRM "ÇABRATI" Sh.A, ka punuar sipas Planit Operativ të aprovuar dhe implementuar nga viti 2021 (shiko shtojcen nr.1), dhe i ndryshuar dhe plotësuar sipas nevojave për shkak të rritjes së

shërbimeve në zgjerim posaçërisht në zonat rurale. Mbeturinat e mbledhura nga konsumatorët grumbullohen në Stacionin Transfer, ku nga aty ringarkohen në kontejnerë të mëdhenj 30 m³, dhe përfundimisht shkarkohen në deponinë në Landovicë.

Vitet	2019		2020		2021	
MUAJIT	SASIA	VLERA	SASIA	VLERA	SASIA	VLERA
JANAR	1,022.20	7,586.87	889.17	5,099.21	1,658.94	9,513.69
SHKURT	1,053.61	7,322.04	1,151.64	6,604.43	1,762.68	10,108.62
MARS	1,684.47	10,699.06	1,345	7,715.03	2,405.42	13,794.60
PRILL	1,560.02	9,904.36	1,167.58	6,695.84	2,307.70	13,237.20
MAJ	1,639.96	9,404.84	1,300.23	7,456.56	1,550.25	8,890.37
QERSHOR	1,775.62	10,182.83	779.1	4,467.98	2,561.05	14,687.11
KORRIK	1,658.90	9,513.46	3,934.88	22,565.75	2,632.57	15,734.46
GUSHT	1,782.79+36.17	12,177.12	2,822.00	17,638.37	1,871.91	11,339.83
SHTATOR	1,705.60	9,781.27	1,972.92	11,735.50	2,404.40	13,788.75
TETOR	1,361.90	7,810.22	1,838.54	10,543.66	2,250.54	12,906.40
NENTOR	654.52	3,753.54	1,319.17	8,464.82	1,732.54	9,935.77
DHJETOR	1,149.60	6,592.73	1,579.95	9,491.62	2,447.22	14,034.32
Totali	17,085.36	104,728.34	20,100.18	118,478.77	25,585.22	147,971.12

Mesatarisht nga Kompania jonë zbrazen 57-63 kontejnerë 1.1 m³ në secilën ngarkesë. Në grumbullim të mbeturinave përdoren edhe kamionë tjerë me sistem të grumbullimit të mbeturinave derë në derë, kryesisht për amvisëri, biznese të vogla dhe të mesme. Gjatë vitit 2021 kemi përdor edhe kamionë vetëngarkues që përdoren në raste të domosdoshme dhe speciale dhe për grumbullimin e mbeturinave nga deponitë e egra, dhe mbeturina të ndërtimit dhe demolimit. Për rrugët e ngushta ende janë duke u përdorur traktor dhe pse ka qenë synim i yni zvogëlimi gradual i përdorimit të tyre apo heqja totale për grumbullimin e mbeturinave. Në të ardhmen duhet të angazhohemi që të njëjtit ti zëvendësojmë me kamion të vegjël.

Operativa gjatë vitit 2021 ka operuar me këtë makineri:

IVECO	WJMA1VPU00CO94329	07-296-BN	2001	12000
IVECO	WJMA1VPU00CO93915	07-297-BN	2001	12000
IVECO	WJMA1VPU00CD94251	07-865-AG	2001	12000
MERCEDES AUTONGARKUES	WDB65213715739797	07-952-BK	1995	10964 cm 3
MERCEDES 2aks	WDB61703415322821	07-893-AG	1988	14610 cm 3
MERC.ECONIK I GJELBERT	WDB9576561V212225	07-968-DR	2007	6374 cm3
MERCEDES ECONIK	WDB9576601V211204	07-169-DR	2007	7201 cm 3

MAN-H18 - TGA	WMAH18ZZV6W061557	07-862-EA	2005	10518 cm 3
RIMORKIO HKA - 18.70	W09HKA1870XH15506	07-110-TA	1999	/
MAN-H18 I BARDH	WMAH18ZZ35M404834	07-144-DD	2004	10518 cm 3
MERCEDES BENZ - 817	WDB6760671K128760	07-906-EH	1995	
HYUNDAI	KMFGA17HEB0001337	07-324-BE	2013	3933 cm3
HYUNDAI	KMFGA17HEB0001291	07-865-AN	2011	3933 cm3
HYUNDAI	KMFGA17HEB0001173	07-873-AN	2011	3933 cm3
VW H7 TRANSPORTER	WV1ZZZ7Z7X008358	07-624-DN	2007	2461 cm 3
SKIP	31031454	07-149-VA	2001	4987 cm 3
ULTA	Y0808012YH0808011	NUK KA	2010	/
TRAKTOR IMT	546398	07-113-VA	2010	2500 cm3
TRAKTOR IMT	501303468	07-112-VA	2006	2500 cm3
MERC.CISTERN SPERKATESE	WDB61702415477803	07-894-CO	1994	10964 cm 3
MERCEDES KOMPAKT. 1017	38011315124203	07-671-DF	1985	6374 cm3
PASSAT	VWVZZZ3BZXE425617	07-891-AG	2000	2496 cm 3
TARKTOR IMT	53303101	0938-KS	2006	2500 cm3
GOLDON	01-10-4-12-0102	NUK KA	/	/

Shpenzimet e Derivateve per periudhen Janar -Dhjetor 2021

Muaji	Viti	Nafte	Benzin	Gjithsejt Çmimi
Janar	2021	11,270.30	140	10,111.03
Shkurt	2021	10,806.80	125	10,187.93
Mars	2021	13,453.20	150	12,981.74
Prrill	2021	12,703.96	305.61	13,009.58
Maj	2021	13,570.47	439.82	13,755.99
Qershor	2021	14,471.23	384.4	15,078.80
Korrik	2021	16,065.31	217.57	16,807.21
Gusht	2021	16,248.81	239.9	16,784.89
Shtator	2021	16,337.83	237	17,541.74
Tetor	2021	14,416.59	198.01	16,736.09
Nentor	2021	14,054.35	287.62	16,177.25
Dhjetor	2021	15,665.35	215	17,362.33
=		L Nafte	Benzin	Per pages Gjithsejt
Gjithsejt		169,064.2L	2939.93L	176,534.58 Euro
Mesatare Mujore		14,088.63L	244.99L	14,711.21 Euro

➤ Plani i ri Operativ – Shtojca nr.1




Rekomandimet/ Konkludimet

1. Kompania sikurse çdo vit, edhe në vitin 2021 ka paraqitur kërkesa Komunës (si domosdoshmëri) për përcaktimin e një ngastre të re për varrezat e qytetit, pasi që ngastra aktuale e varrezave është në konsumim, dhe sipas stafit udhëheqës të varrezave parcela ekzistuese është e mjaftueshme edhe për një periudhë 1-2 vite deri në konsumim komplet të ngastrës, andaj nevojitet qasje serioze nga komuna që të sigurojë një parcelë për nevoja të varrimeve në të ardhmen për një kohë më të gjatë.
2. Rastet gjyqësore janë një problem i cili ka edhe kosto, raste të cilat duhet të trajtohen në vazhdimësi dhe janë duke i kushtuar në kohë dhe mjete financiare kompanisë si pasojë e ndryshimeve të qeverisjes lokale dhe shkarkimeve të Bordit të Drejtorëve pa përfunduar mandate.
3. Borxhet e akumuluar nga Komuna, duhet të paguhen me kohë, mjete financiare me anë të cilave Kompania mund të bëjë planifikime dhe realizime të mirëfillta.
4. Statuti duhet të ndryshohet dhe plotësohet, kjo është vonuar në mungesë të korumit të Komisionit Komunal të Aksionarëve dhe Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.
5. Duhet të procedohen hapat për shlyerjen e borxheve të vjetra dhe të trajtohet si teme në asamblenë komunale në Gjakovë.
6. Vlerësimi i performancës së Bordit të Drejtorëve, të bëhet nga Komisioni Komunal i Aksionarëve.
7. Mbrojtja e të dhënave softverike të KRM "Çabrati" Sh.A
8. Miratimi dhe pëlqimi nga Asambleja Komunale për shfrytëzimin e platos tek Administrata e Kompanisë Rajonale të Mbeturinave "Çabrati" Sh.A., pronë e cila është në pronësi të Kompanisë dhe synohet të shfrytëzohet për aktivitet ekonomik kryesisht për parking me pagese për vetura.

Përgaditur:

Ardiana Çela Baraku

Kryesuese e Bordit të Drejtorëve të KRM "Çabrati" SH.A



Datë, 18 shkurt 2022

